

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trupi i 39-vjeçarit u gjet i copëtuar në një apartament në Torino, 26-vjeçari pranon vrasjen: E vrava pa da shje pas një sherri
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/27/trupi-i-39-vjecarit-u-gjet-i-copetuar-ne-nje-apartament-ne-torino-26-vjecari-pranon-vrasjen-e-vrava-pa-dashje-pas-nje-sherri/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 08:37:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	27 shtator 2026, 08:35:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 27 shtator 2026, 08:34:00 UTC → 27 shtator 2026, 08:36:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e78a44fa4f70872d7de9984835c1808e1eaaeb3b49bd7d1d8e26d2790728540a
TEKSTI	e6a933dac1a55fe8850a1807ab8064ca90dd0f52e1fc6e0e726d2652e73e9c39
PAMJA	9d727754d739ae331beb6bd4c36eefd597df10f71b11bcc8d589a4ce47b710b8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6bb605b7bcfa0c6de114f455b444f39e21ca530a8b0288e1242c9d9b9022c098
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b15fa4fb9899cfd04d55deb4808016b106f413d91b2f45c6fda6eeee1406fd0e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6bb605b7bcfa0c6de114f455b444f39e21ca530a8b0288e1242c9d9b9022c098>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

Trupi i 39-vjeçarit u gjet i copëtuar në një apartament në Torino, 26-vjeçari pranon vrasjen: E vrava pa dashje pas një sherri

27/09/2026 10:35



Një ngjarje makabër ka tronditur Torinon, ku 39-vjeçari Fabio Colapietro, nga Chivasso, u gjet i copëtuar në një apartament në periferi të veriut të qytetit. Për vrasjen është ndaluar 26-vjeçari Christian Matheus De Oliveira Morando, i cili gjatë marrjes në pyetje para gjyqtarit ka pranuar se e ka vrarë viktimën, por pretendon se ngjarja ka qenë e paqëllimshme.

Sipas deklarimeve të tij, gjithçka ndodhi pas një konflikti për para, gjatë një periudhe prej disa ditësh kur në apartament po konsumohej alkool dhe lëndë narkotike. Avokati i 26-vjeçarit tha se klienti i tij është "i hutuar" dhe se, sipas tij, "nuk mund t'i ketë bërë të gjitha i vetëm".

Hetuesit dyshojnë se vrasja ka ndodhur gjatë një feste ku ishin konsumuar lloje të ndryshme drogash. Avokati përmendi MDPHP, crack, LSD, kërpudha halucinogjene dhe kanabis, krahas pijeve të forta alkoolike.

Sipas versionit të të dyshuarit, të nesërmen ai u zgjua dhe i thanë se Colapietro mund t'i kishte vjedhur rreth 50 euro. Pas kësaj nisi një sherr fizik, ku, sipas avokatit, të pranishmit u përlëshën dhe 39-vjeçari ra përtokë dhe vdiq.

"E vrava, por pa dashje. Sigurisht që nuk ishte e planifikuar", ka thënë 26-vjeçari para gjyqtarit.

Kur u pyet nëse e kishte kapur viktimën nga qafa, ai tha se nuk e kujtonte. Sipas avokatit, pas incidentit janë tentuar për rreth dy orë reanimimi me frymëmarrje gojë më gojë dhe masazh kardiak.

Në kuadër të hetimit janë marrë në pyetje edhe Nicole Formichetti, 47 vjeçe, mësuese që kishte marrë me qira apartamentin, dhe Keith Butig, 22 vjeçe, të dyshuara për favorizim dhe përfshirje në fshehjen e trupit.


Formichetti nuk iu përgjigj pyetjeve të gjyqtarit, ndërsa avokatët e saj thanë se nuk ishte në gjendje ta bënte këtë dhe se mund të merret në pyetje në një moment tjetër.

Butig, një grua transgjimore, mohoi të ketë marrë pjesë në vrasje. Avokati i saj tha se ajo ishte e pranishme gjatë festës dhe kishte blerë qeset e zeza, por nuk kishte marrë pjesë në fazat e mëvonshme. Sipas mbrojtjes, ajo ishte në gjendje të rënduar dhe ishte mbyllur në një dhomë.

Tani pritet vendimi i gjyqtarit për konfirmimin e ndalimeve, ndërsa hetimet vijojnë për të sqaruar plotësisht rrethanat e vrasjes dhe rolin e secilit prej personave të përfshirë.

Top Channel

Kryesore



Thirrja urgjente/ Rama mesazh shqiptareve nga Rinasia direkt pas kthimit nga SHBA, zbardhen detajet

08:02

Aksident tragjik në Maliq/ Po nxirrte rrobat nga bagazhi, makina rrëshqet dhe e zë poshtë, humb jetën 44-vjeçari

08:41

Ngushtica e Hormuzit/ Trump hedh poshtë propozimin e Iranit, Teherani pret përgjigjen e SHBA-së

08:18

Notat e Top Channel/ Berisha si djali i madh i shtëpisë, Gjimshiti e Asllani gatuajnë gol "sheikësh". Sekretet e... Maran

07:48

Kryeqyteti mirëpret "Tiranathlon"/ Ja rrugët ku do të kufizohet qarkullimi i automjeteve në kryeqytet dhe linjat urbane që do devijojnë

08:28

Më të lexuarat

Thirrja urgjente/ Rama mesazh shqiptareve nga Rinasia direkt pas kthimit nga SHBA, zbardhen detajet

VIDEO/ Shqipëria në versionin "turbo", kuqezinjët dominojnë Bjellorusinë dhe marrin 3 pikë të merituara

Ekskluzive/ Mbyllën hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria i komunikoi akuzën autorit Elvis Shkambi

Statusi i Saimir Tahirit në Facebook, miqtë e tij tregojnë për Top Channel çfarë pritet të thotë ish-ministri i brendshëm socialist

Top Channel publikoi videon e Peter Magyar, ja si reagon kryeministri hungarez (FOTO)

"Policia dhe protesta, njësoj si në Tiranë"/ Rama nga SHBA: Njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë, shefi ishte shqiptar

Tre të rinjtë shqiptarë humbën jetën në Greqi, dëshmia rrëqethëse e mikes së familjes: Çifti i ri sapo ishin martuar, prisnin fëmijën e parë

FOTO/ Nga "Arrestoni Ramën" te mbështetja për liderët e UÇK, pankartat politike marrin vëmendjen në ndeshjen e Kombëtares

"Asisti më i bukur në karrierë"/ Hysaj flet për të ardhmen: I kam kërkuar presidentit Duka

I Bota »



Papa Leone XIV mbërrin në Lourdes, mijëra besimtarë marrin pjesë në Meshën në shenjtëroren e famshme

27/09 10:30



Alarm pranë bazës amerikane në Britani/ Arrestohen disa persona, evakuohen banorët

27/09 09:58



Hiri vullkanik nga Etna paralizon aeroportin e Katantias, pezullohen të gjitha fluturimet deri në mesnatë

27/09 09:56



Të shtëna me armë zjarri në një ishull të njohur për turizmin luksoz, katër të vdekur në Karaibe

27/09 09:21



Marshimi që ndezi trazirat në Irlandën e Veriut rikthehet pas 30 vitesh, gjykata jep lejen

27/09 09:17



Ngushtica e Hormuzit/ Trump hedh poshtë propozimin e Iranit, Teherani pret përgjigjen e SHBA-së

27/09 08:18

Na ndiqni:



I Video »



Top Channel/ Aksidenti tragjik në Maliq, viktimat punonte si taksist. Ja si ndodhi ngjarja



Top Channel/ Goditen grupet e drogës pranë shkollave në Tiranë, 31 në burg, 14 në kërkim



Top Channel/ Rama: "Zvërmeci" do të realizohet! Po studiojmë ndikimin dhe riskun në mjedis



Top Channel/ 700 mijë njerëz ndjekin meshën madhështore të Papa Leonit, mesazhi për rininë



Top News – Trump 'i shtrin dorën' Putin/ Senatorët amerikanë kundërshtojnë – Legjitimon luftën!



Top Channel/ Vrasja e gjyqtarit, mbyllet hetimet. Prokuroria i komunikon zyrtarisht akuzën autorit

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Bileta – Portokalli
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

kontratën e veçantë

Aksidenti tragjik në Maliq/ Po nxirrte rrobat nga bagazhi, makina rrëshqet dhe e zë poshtë, humb jetën 44-vjeçari